



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
Organizata e Infermierëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës Komanda medicinale dhe tjerë të bashkësive të shëndetit në Kosovë Organisation of Nurses and other health professionals of Kosovo		
KOSOV. ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot. 950	Str. -3-	Data: 08.10.2019
Broj. prot.	Str.	Datum:
Prot. no.	Str.	Date:
PRISTINA • PRISTINA		



## MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

**E lidhur me datën 08/10/2019 ndërmjet palëve:**

1. Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës përfaqësuar nga Z. Naser Rrustemaj dhe
2. Qëndres Psiko-sociale për Traumatoterapi –Diakonie Kosova, përfaqësuar nga Znj. Xhevahire Balaj

### Hyrje

Diakonie Kosova është organizatë joqeveritare që funksionon që nga viti 2007 në Mitrovicë. Në kuadër të projekteve të shumta që implementohen nga Diakonie Kosova nga viti 2012 është themeluar Qendra psiko- sociale për traumatoterapi.

Qendra Psiko - Sociale për Trauma Terapi ka disa objektiva kryesorë:

- Ofrimi i shërbimit të trauma terapisë për popullatën e Kosovës pa diskriminim në baza etnike, religjioze, moshe, gjinie etj.
- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale në trauma terapi për profesionistët e shëndetit mendor, mjekë, infermierë, mësues, punëtorë social etj.
- Mbikëqyrje profesionale për personat që punojnë me persona të traumatizuar dhe përkthimi i literaturës në fushën e trauma terapisë.

Aktualisht Qendra Psiko-sociale për traumatoterapi funksionon në zyrën Qendrore në Mitrovicën e Jugut dhe degët e saj në Mitrovicën e Veriut, Prishtinë dhe Prizren.

### Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin ndërmjet Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë dhe Qendrës Psiko Sociale për Traumatoterapi, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të profesionistëve shëndetësorë në fushën e traumës dhe trauma terapisë sikurse problematikave të tjera në fushën e shëndetit mendor.

### Fushat e bashkëpunimit



Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, bashkëpunimi do të përqëndrohet në:

- 1.1 Ngritje e kapaciteteve profesionale të infermierëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë përmes trajnimeve profesionale në fushën e traumës dhe trauma terapisë dhe problematikave të tjera të ndërlydhura në fushën e shëndetit mendor
- 1.2 Organizimi i Konferencave shkencore që promovojnë rëndësinë e shëndetit mendor me fokus tek fusha e traumës dhe trauma terapisë dhe mundësia e avancimit profesional për profesionistët shëndetësorë në këto problematika.
- 1.3 Realizimi i ligjeratave për infermierë e profesionistë të tjerë shëndetësor në fushën e menaxhimit të stresit dhe parandalimit të diegies profesionale.

### **Obligimi i palëve**

**Oda e Infermierëve, mamie dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë** do të facilitojë akreditimin e programeve të trajnimeve dhe Konferencave të realizuara nga Qendra Psikosociale për Traumaterapi - Diakonie Kosova,

**Qendra Psikosociale për Traumaterapi - Diakonie Kosova** obligohet të ofroj trajnime profesionale ,Koncerenca, ligjerata në fushën e traumës dhe trauma terapisë për infermierë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në çdo rast, palët angazhohen të zgjidhin mosmarrëveshjet që burojnë nga ky memorandum me anë të bisedimeve, ne raste që nje praktikë e tillë nuk jep rezultate atëherë palët detyrohen të ndërprejnë bashkëpunimin.


### **Hyrja në fuqi dhe zbatimi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët nënshkruese dhe është e vlefshme nga dita e nënshkrimit deri më 31.12.2020, me mundësi vazhdimi.

Palët mund të ndërpresin zbatimin e marrëveshjes duke njoftuar me shkrim palën tjetër së paku 1 muaj para datës së ndërprerjes.

**Marrëveshja pasi lexohet, nënshkruhet me vullnetin e lirë të palëve.**

Z. Naser Rrustemaj  
Kryetar i Odës së Infermierëve, mamive  
dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë



Znj. Xhevahire Balaj  
Drejtoreshë e Qendrës –Psiko-Sociale  
për trauma terapi –Diakonie Kosova

